



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERET PUBLIKE

Nr. 201/6 prot.

Tiranë, më 24.5.2022

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 519, datë 25.3.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Kastriot Gramshi
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 9.5.2022 është njoftuar vendimi nr. 519, datë 25.3.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Kastriot Gramshi, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c” e aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 16.5.2022, është depozituar akti: “Rekomandim për paraqitje ankimi”¹, nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor, nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, datë 16.5.2022, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 519, datë 25.3.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

¹ Akti nr.187/1 prot., datë 16.5.2022.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Kastriot Gramshi, ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1² e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Kastriot Gramshi, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si *ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si *DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si *KLGG*), nga të cilat rezulton se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit Kastriot Gramshi*”³ ka referuar se:

- i. Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklarim të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Kastriot *** Gramshi⁴, ka referuar “*Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Kastriot *** Gramshi*”.

2.3 **KLGG**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti, gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin⁵ për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, Kastriot Gramshi.

3. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e të ardhurave, shpenzimet etj., për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioni, pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat dhe faktet e dala nga hetimi administrativ, provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e barrës së provës, ka arritur në përfundimin se: [...] *Komisioni krijoi bindjen se subjekti i*

² Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

³ Shkresa e ILDKPKI-së me nr. *** prot., datë **.1.2019.

⁴ Shkresa e DSIK-së nr. *** prot., datë **.10.2017, e deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë **.10.2021.

⁵ Raport i KLGG-së nr. *** prot., datë **.7.2020.

rivlerësimi Kastriot Gramshi ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ka kryer deklarime të sakta në Deklaratën “Vetting” dhe ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera për të gjithë periudhën e rivlerësimit. Pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet periodike vjetore nuk rezultuan të kenë qenë të qëllimshme apo të kenë pasur si synim fshehje të pasurive apo deklarime të rreme. Subjekti nuk rezultoi të ketë qenë në ndonjë rrethanë të konfliktit të interesit. Veç këtyre, për një vlerësim pozitiv të kriterit pasuror, Komisioni çmon me rëndësi faktin se në lidhje me këtë subjekt rivlerësimi janë kryer hetime të thelluara edhe për deklarime të kryera pas Deklaratës “Vetting”, pikërisht në funksion të krijimit të bindjes së brendshme në lidhje me saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve të kryera para kësaj deklarate nga ana e subjektit dhe personave të lidhur. Nga hetimet rezultoi se çdo deklaram pas Deklaratës “Vetting” ka qenë në koherencë të plotë dhe në vijueshmëri të deklarimeve që nga viti 2014, kur subjekti ka rifilluar të ushtrojë detyrën e gjyqtarit dhe deri në Deklaratën “Vetting” [...] ⁶. Në këto kushte, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, z. Kastriot Gramshi, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

3.2 Për kontrollin e figurës. Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë e subjektit, edhe pas hetimit administrativ, ka arritur në përfundimin se: [...] *Duke qenë se gjatë procesit të rivlerësimit nuk u evidentuan të dhëna që cenonjë figurën e subjektit të rivlerësimit si kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo veprimtari të tjera kriminale, si dhe të dhëna për korrupsion, në përfundim të këtij procesi, subjekti u vlerësua i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës [...] ⁷. Në këto kushte, Komisioni, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Kastriot Gramshi, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe Kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga KLGJ-ja, denoncimet e depozituara në Komision dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: [...] *Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016. [...] ⁸. Për sa më sipër, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Kastriot Gramshi, ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.*

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, Komisioni, me vendimin nr. 519, datë 25.3.2022, pasi kreu bisedimet për marrjen e vendimit në praninë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit të nenit 55, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur: “1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Kastriot Gramshi, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

⁶ Referohuni arsyetimit të Komisionit, në faqen 54 të vendimit.

⁷ Referohuni arsyetimit të Komisionit, në faqet 54-55 të vendimit.

⁸ Referohuni arsyetimit të Komisionit, në faqen 67 të vendimit.

II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

5. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”⁹ e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2¹⁰ e ligjit nr. 84/2016, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 16.5.2022, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë: “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 519, datë 25.3.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Kastriot Gramshi (bashkëlidhur këtij ankimi).

6. Në mënyrë të përmbledhur, ONM vlerëson se vendimi i Komisionit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Kastriot Gramshi, ka mangësi serioze logjike dhe faktike në pjesën arsyetuese, rezultat i një procesi rivlerësimi të papërshtatshëm dhe të pasaktë për kriterin e pasurisë dhe aplikimit të gabuar të kuadrit ligjor në fuqi. Komisioni, i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, çmon se një vlerësim i duhur i kriterit të pasurisë në tërësinë e tij, do të çonte në shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë që ai nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59, pika 1, germa “a”, lidhur me nenin 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016. ONM, gjithashtu, beson se një vlerësim i përgjithshëm i mangësive të evidentuara do të ndikojë në rikthimin e besimit të publikut.

6.1 ONM rekomandon që Komisioneri Publik të ankimojë rezultatet e dala nga vlerësimi i kriterit të pasurisë në tërësinë e tij, për t'i mundësuar Kolegjit të kryejë një analizë financiare të plotë për të gjitha vitet, për vlerësimin e duhur mbi çështjet si vijon: (i) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht shumën e kredisë të marrë në vitin 2012 dhe këstin e dytë të blerjes së pasurisë “Shtëpi me sip.180 m², ndodhur në New York, SHBA” (jo deri në tetor 2021), dhe nuk ka të ardhura të ligjshme për ta paguar atë; (ii) ONM vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka të ardhura të ligjshme për krijimin e depozitave/kursimeve në llogari bankare në SHBA; (iii) Në analizën financiare, për një vlerësim korrekt të kriterit të pasurisë, në përputhje me interpretimin korrekt të situatës ligjore dhe faktike të kësaj çështjeje, duhet të përfshihet edhe periudha kohore përpara vitit 2005, veçanërisht vitet 2003 dhe 2004. Në këto kushte, balanca negative për vitet 2012 dhe 2014 mund të arrijë në shumën rreth 40.000 USD.

6.2 ONM parashton se interpretimi i Komisionit lidhur me kuadrin ligjor të zbatueshëm, sipas të cilit: “(vi) ...Komisioni nuk mund të anashkalojë faktin që si periudha gusht 2003 – dhjetor 2004, ashtu dhe periudha 2005 – 2012, kur është blerë pasuria, i përkasin periudhës jashtë ushtrimit të detyrës dhe kur subjekti ka qenë në SHBA... dhe se ... pozita e subjekteve të rivlerësimit nuk mund të rëndohet me qëllim provueshmërinë e ligjshmërisë së pasurive me të ardhura të cilat nuk janë krijuar dhe as nuk lidhen me periudhën e rivlerësimit kalimtar, e në këtë mënyrë, subjektet e rivlerësimit nuk mund të penalizohen për këtë arsye”, nuk mund të pranohet. Edhe pse subjekti i rivlerësimit nuk ishte në detyrë, vlerësimi i pasurisë dhe analiza financiare nuk mund të kufizohen nën këtë mënyrë arsyetimi. Ky qëndrim është konfirmuar në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në vendimet (JR) nr. 31/2019, (JR) nr.12/2020, (JR) nr.13/2020 dhe (JR) nr. 3/2021.

⁹ “Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra ... u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit.”

¹⁰ “Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.”

III. Vlerësimi i Komisionerit Publik

7. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).
8. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit kontrollues/rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).
9. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.
10. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave të administruara.
11. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, pasi shqyrtoi dhe vlerësoi vendimin nr. 519/2022 dhe aktet shoqëruese të tij, bazuar në Rekomandimin e ONM-së, datë 16.5.2022, çmon se vendimi është i cenusshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Lidhur me rrethanat ligjore e të faktit, sikurse do të trajtohen edhe në vijim, Komisioneri Publik i referohet edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si organi gjyqësor, që vendos për vlerësimin përfundimtar në këtë proces.
12. Në përfundim të sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 4, 59 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 519/2022, të Komisionit.

IV. Analiza e shkaqeve të ankimit

IV.A. Kontrolli i pasurisë

13. Në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencës së Kolegjit, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit ("Vetting" dhe ato periodike). Në çdo rast, subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.
14. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Kastriot Gramshi, ka deklaruar për herë të parë në vitin 2014 dhe, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e

pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratat e interesave private periodike për vitet 2014 - 2017 (në vijim DV -20--) dhe, në datën **.1.2017, ka dorëzuar në ILDKPKI Deklaratën “Vetting”, sipas shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016 (në vijim D-Vett.).

15. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratës së interesave private para fillimit të detyrës, deklaratave periodike vjetore dhe Deklaratës “Vetting”, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D të aneksit të Kushtetutës, Komisioneri Publik vlerëson të ndalet në analizën e shkakut të ankimit lidhur me saktësinë dhe mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme në krijimin e pasurive të deklaruara, kryesisht lidhur me pasurinë “Shtëpi me sip.180 m², ndodhur në New York, SHBA” dhe depozita/kursime në llogari bankare në SHBA, të cilat trajtohen në vijim:

16. Shtëpi me sip. 180 m², në New York, SHBA

16.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *shtëpi banimi me sip.180 m², në New York, SHBA*¹¹, blerë në datën **.5.2012. Çmimi i blerjes në shumën 290.000 USD dhe pjesa takuese 50%. Burimi i krijimit të pasurisë deklarohet *kursime të akumuluar para emërimit si Gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë **.7.2014, si dhe kredi e marrë nga *** ** Bank.*

16.1.1 Në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, të D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kredi ndaj *** ** Bank, SHBA, dhe, deri më datë **.12.2016, shuma e detyrimit financiar që ka mbetur pa shlyer është 184.646 USD. Shlyerja fillon më **.5.2012 dhe përfundon më **.5.2032. Interes fiks 4,25 %, kësti mujor (përfshirë principal + interesa) 1.879,3 USD.*

16.2 Në Deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës (dorëzuar më **.8.2014 në ILDKPKI), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Shtëpi banimi, me sip.180 m², në New York, blerë në datën **.5.2012. Çmimi i blerjes në shumën 290.000 USD dhe pjesa takuese 50%. Burimi i krijimit: Pagim i këstit fillestar prej 29.000 USD dhe kredi nga *** ** Bank, në vlerën 261.000 USD.*

16.2.1 Në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, të deklaratës së mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kredi për blerje shtëpi banimi, me sip.160 m², (USA) ***, në *** ** Bank, më **.5.2012, në shumën 261.000 USD, me afat 20 vjet. Shlyerja fillon më **.5.2012 dhe përfundon më **.5.2032, me interes fiks 4,25 % në vit dhe me këst mujor 1.346,84, plus taksa dhe sigurim pasurie mbi pronën e paluajtshme (4.000 USD në vit). Në rubrikën ku kërkohet të deklarohet shuma e detyrimit financiar që ka mbetur pa shlyer deri në datën e fillimit të punës, ka deklaruar shumën 217.500 USD.*

16.3 Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti, z. Gramshi, është përgjigjur lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, respektivisht në: (i) Pyetësorin standard, në përgjigje të pyetjes 4 shprehet se: [...] *Në vitin 2012, financiar në shumën prej 261.000 USD nga *** ** Bank, për blerjen e shtëpi banimi dyfamiljeshë, në adresën: *** ** ***, Bronx NY, ***, me*

¹¹ Shtëpi banimi, sip.180 m², *** ** ***, Bronx, New York ***(USA).

*bashkëpronar Kastriot Gramshi dhe ***.*** [...], ndërsa në përgjigje të pyetjes 9, të po këtij pyetësori deklaroi: [...] Blerje shtëpi banimi e përbërë nga dy apartamente/dyfamiljeshe, në bashkëpronësi me vëllain ***.*** ... Çmimi i blerjes 290,000 USD (dyqind e nëntëdhjetë mijë). Kësti i parë/down payment 29.000 USD (njëzet e nëntë mijë). Ndërsa diferenca prej 261.000 USD, kredituar nga *** *** Bank [...]; (ii) në Pyetësozin nr. 2, në përgjigje të pyetjes 5, shprehet se: [...] Diferenca e çmimit (pas pagesës së këstit të parë/down payment), është kredituar nga *** *** Bank [...]; (iii) në Pyetësozin nr. 3, në përgjigje të pyetjes 4, deklaroi se: [...] Pagesa e këstit të parë (down payment on contract) e kërkuar nga Banka është 10% e vlerës së shitjes së pasurisë, në vlerën 29.000 USD (njëzet e nëntë mijë). Kjo shumë e paguar nga të dy vëllezërit, por transaksioni është kryer nga unë për llogari të zyrës avokatore... Shuma e kredituar (Morgage) nga *** *** Bank është 217.500 USD... Me qëllim finalizimit e kontratës së shitblerjes është kërkuar që diferenca e çmimit (290.000 USD – 29.000 USD - 217.500 USD) me shumën e kredituar nga *** *** Bank, duhej të mbulohej nga pala blerëse. Meqenëse nga ana jonë (palës blerëse) është rënë dakord të vijohej me procedurën e blerjes së kësaj pasurie, dhe shuma e paguar nga kursimet e të dyve, por transaksioni është kryer nga ana e vëllait ***.***, është paguar për llogari të *** *** (Banka kredituese e shitësit të pronës) shuma prej 46.638,43 USD (shih Cashier's Check NON NEGOTIABLE, dt. **.5.2012) [...].*

16.4 Komisioni, me anë të rezultateve të hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, duke vlerësuar se: [...] (i) subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në DPDFD-në e vitit 2014, si dhe në pyetësozin standard në lidhje me shumën e kredisë bankare të marrë për blerjen e banesës në SHBA, duke deklaruar atë në shumën 261.000 USD, pra, në një vlerë më të madhe se vlera e aprovuar dhe e disbursuar e kësaj kredie prej 217.500 USD; (ii) subjekti nuk ka deklaruar pagesën e shumës prej 46.638,43 USD, paguar prej tij dhe vëllait të tij, për blerjen e banesës në New York USA, duke u mjaftuar vetëm me deklarimin e pagesës së paradhënies në shumën 29.000 USD; (iii) subjekti dhe familja e tij nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar në total shumën prej 75.638,43 USD, e cila ka shërbyer si downpayment/ pagesë e kryer brenda datës **.5.2012 [...].

16.5 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, për sa i përket pasaktësive në deklarimin e burimit: (i) kredi nga *** *** Bank, dhe (ii) pagesë e këstit të dytë në shumën 46,638 USD, në mënyrë të përmbledhur, ka deklaruar në deklaratimet në DPDFD-në e vitit 2014, si dhe në pyetësozin standard, shumën e kredisë bankare në vlerën 261.000 USD, ndërkohë që vlera e aprovuar dhe e disbursuar e kësaj kredie ka qenë 217.500 USD, janë bërë me qëllimin për të krijuar konsistencë dhe jo konfuzion, duke iu përmbajtur kushteve thelbësore të kontratës së shitjes së pasurisë, sipas së cilës vlera e blerjes, prej 290.000 USD, përbëhet nga downpayment/kapar 29.000 USD dhe 261.000 USD kredi bankare. Ndërsa, në seksionin “detyrime”, ai ka deklaruar vlerën e kredisë 217.500 USD. Subjekti deklaroi që kjo ka qenë mënyra se si e ka kuptuar formularin e deklarimit në vitin 2014, deklarim i cili ka vijuar edhe në pyetësozin standard, duke ndjekur të njëjtën logjikë. Në vijim të argumenteve të tij, subjekti vijon të parashtrijë që, pasi është pyetur nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, ai ka sqaruar të gjithë situatën, duke paraqitur edhe çeqet e paguara për përfundimin e transaksionit për blerjen e shtëpisë.

16.6 Në përfundim, Komisioni ka arsyetuar¹² se: [...] i çmoi bindëse pretendimet e subjektit duke vlerësuar se: (i) deklarimi i kredisë së marrë nga ***.***. Bank, si një nga burimet e krijimit të pasurisë objekt verifikimi, jo në vlerën 217.500 USD, por në vlerën 261.000 USD, në DPFDF-në e vitit 2014 (dhe pyetësorin standard), është bërë duke iu referuar përcaktimit të kontratës së shitjes së datës **.2.2012, ndërkohë që në rubrikën detyrime financiare të DPV-së për vitin 2014, subjekti ka deklaruar saktësisht kredinë në vlerën 217.500 USD. (ii) mosdeklarimi në DPFDF-në e vitit 2014, por edhe në vijim në pyetësorin standard, i shumë prej 46.638 USD, paguar nga vëllai i subjektit, në datën **.5.2012, nuk është bërë me qëllim fshehjen e kësaj pagese, por për të qenë në të njëjtën linjë me kontratën e shitjes me datë **.2.2012, sidomos në kushtet kur është vërtetuar se pagesa e kësaj shume është kryer me çek në rrugë bankare, një fakt lehtësisht dhe tërësisht i evidentueshëm. Për më tepër, në përfundim të procesit, u vërtetua se subjekti dhe vëllai i tij kanë pasur të ardhura të ligjshme për të kryer këtë pagese brenda datës **.5.2012, çështje e trajtuar në vijim, në paragrafët 48 dhe 49 të këtij vendimi. (iii) Për rrjedhojë, pasaktësitë e evidentuara, të cilat nuk kanë sjellë asnjë pasojë, nuk mund të përbejnë shkak për penalizim të subjektit. Në këtë vlerësim, Komisioni i referohet edhe qëndrimit tashmë të konsoliduar nga Kolegji dhe praktikës së Komisionit, të cilët konsiderojnë se pasaktësitë në deklaratimet periodike të pasurisë nuk përbejnë shkak të veçuar për të ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore, në rastet kur nuk kanë sjellë pasojë [...].

16.7 Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara në dosje të Komisionit, bazuar në Rekomandimin për paraqitje ankimi të ONM-së, datë 16.5.2022, i drejtohet juridiksionit kontrollues të Kolegjit, për çështjen e pasaktësisë në deklaratim të subjektit, z. Gramshi, pasur në vëmendje rrethanat e parashtruara në Rekomandimin e ONM-së¹³ për sa vijon:

16.7.1 [...] Kontrata e shitjes është nënshkruar në muajin shkurt 2012, kredia është disbursuar në muajin maj 2012, ndërsa deklarimi i parë i subjektit të rivlerësimit (DPFD) është bërë në muajin gusht 2014, periudhë kjo më shumë se dy vjet nga marrja e kredisë. Subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin që të deklaronte shumën e saktë të kredisë së disbursuar nga banka, si dhe duhet të shpjegonte pse vlera e kredisë në kontratën e shitjes është e ndryshme nga vlera e kredisë së disbursuar. Ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi këtë informacion deri më tetor 2021 [...].

16.7.2 [...] konkluzioni i Komisionit në vendimin e tij, ku konfirmohet se: “subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktësisht vlerën e kredisë në shumën 217.500 USD, në rubrikën e detyrimeve”, nuk rezulton të jetë i saktë. Subjekti i rivlerësimit në këtë rubrikë deklaroi se kredia e marrë ishte në shumën 261.000 USD dhe detyrimi i mbetur në 2014 ishte 217.500 USD [...].

16.7.3 [...] ONM vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi saktësisht shumën e kredisë dhe këstin e dytë të pagesës në D-Vett., në Pyetësorin standard dhe Pyetësorin nr. 2. Vlera e saktë e kredisë dhe e këstit të dytë të pagesës janë deklaruar vetëm në përgjigje të Pyetësorit nr.3, pyetja 4, në muajin tetor 2021 [...].

16.7.4 [...] Në dritën e sa më sipër, është e mundur të pohohet se deklaratimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit në lidhje me huan (dhe specifikisht në lidhje me shumën e saj) përbejnë

¹² Referohuni arsyetimit të Komisionit, në faqen 25-26 të vendimit.

¹³ Referohuni pikës 2, germa “a”, faqe 2 – 6, të Rekomandimit të ONM-së.

mungesë të deklaramit të saktë apo, më së paku, një situatë të pasaktësisë në deklaram deri në muajin tetor 2021 (deri dhe sikurse konfirmohet nga përgjigjet e dhëna në Pyetësorin nr.3), të cilat, në përfundim, çojnë në thyerje të besimit të publikut¹⁴ [...].

16.8 Komisioneri Publik vëren se rrethanat e pasqyruara në Deklaratën e Parë (DPFD) dhe D-Vett., si dhe përgjigjet gjatë hetimit administrativ në Komision deri në përgjigjet e subjektit në Pyetësorin nr. 3, janë jo të plota mbi burimin e krijimit të pasurisë “Shtëpi me sip.180 m², në New York, SHBA”, konkretisht e pasaktë për shumën e kredisë disbursuar nga *** Bank, e pasaktë dhe e pamjaftueshme për pagesën e këstit të dytë, në shumën 46.680 USD.

16.9 Në përfundim, Komisioneri Publik vlerëson se mospërputhjet e mësipërme në deklaramet e subjektit lidhur me vlerën e kredisë dhe, si rrjedhojë, pagesën e këstit të dytë, çojnë në deklaram të pasaktë.

17. Në lidhje me burimin e krijimit të pagesave të këstit të parë në vlerën 28.000 USD dhe të dytë në vlerën 46.638 USD, për pasurinë “Shtëpi me sip.180 m², në New York, SHBA”

17.1 Komisioni ka analizuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit, personave të lidhur dhe personave të tjerë të lidhur me të, për të mbuluar me burime të ligjshme pagesat e kryera deri në datën **.5.2012, për blerjen e pasurisë “Shtëpi me sip.180 m², në New York, SHBA”, si dhe shpenzimet e tjera të periudhës, të evidentuara gjatë hetimit administrativ, duke kryer analizën financiare të subjektit, z. Gramshi, dhe familjarëve të tij, për periudhën 2005 - **.5.2012¹⁵, nga e cila ka rezultuar se subjekti dhe familja e tij nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të paguar shumën 75.638 USD, për blerjen e pasurisë “Shtëpi me sip.180 m², në New York, SHBA”, për shkak të një balance negative prej – 131.085 USD. Me anë të rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës.

17.2 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e rezultateve të hetimit administrativ, ka kundërshtuar konstatimin e Komisionit, duke kërkuar rishikimin e zërave të analizës financiare të kryer, lidhur me¹⁶: (i) Shpenzimet e jetesës për të gjithë familjen, për periudhën e analizuar nga Komisioni, duke pretenduar reduktimin e tyre më vlerën 20.699 USD; (ii) Të ardhurat e gjithë familjes për periudhën e analizuar, duke kërkuar përfshirjen e të ardhurave të rimbursuara nga taksat, nga shteti amerikan, për familjen e subjektit dhe të vëllait të tij, në vlerat 31.637 USD dhe 4.018 USD, sipas akteve të depozituara, ndërsa për të ardhurat e z. ***. ***. (i ati i subjektit të rivlerësimit), për vitet për të cilat mungojnë aktet, të llogariten me metodën e analogjisë dhe, bazuar në aktet dhe arsyetimin mbi ligjet në fuqi të shtetit amerikan për përfitimin e masës së pensionit, deri në **.5.2012, të merren në total në vlerën 77.834 USD;

¹⁴ Referohuni jurisprudencës në vendimin e Kolegjit (JR) 2/2020: “24.5. Kolegji arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaram lidhur me burimin e krijimit të pasurisë Automjet tip “Mercedes Benz”, ndaj në këto rrethana, meqenëse është vetëm një deklaram i pasaktë në Deklaratën periodike, vlerësohet se kjo pasaktësi e vetme nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkaku shkarkimi. Por kjo situatë ligjore dhe faktike, parë në vlerësimin tërësor, në kuptim të nenit D, pika 5 e aneksit të Kushtetutës, bën të aplikueshme kërkesat e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në kuadrin e cenimit të besimit të publikut”; dhe

“25.3. Lidhur me pasurinë ‘garazh’, Kolegji arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaram lidhur me burimin e krijimit të saj, ndaj në këto rrethana, duke qenë se është pasaktësi e identifikuar në Deklaratën periodike, ndërsa në Deklaratën “Vetting” është deklaruar burimi, vlerësohet se kjo pasaktësi e vetme nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkaku shkarkimi, por kjo situatë ligjore dhe faktike, parë në vlerësimin tërësor, në kuptim të nenit D, pika 5 e aneksit të Kushtetutës, bën të aplikueshme kërkesat e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në kuadrin e cenimit të besimit të publikut”.

¹⁵ Referohuni arsyetimit të Komisionit, në pikat 43.2 dhe 44, të vendimit.

¹⁶ Referohuni shpjegimeve të subjektit, në f. 22 e në vijim, të prapësimeve të subjektit.

(iii) Balancat e likuiditeteve në llogaritë bankare, bazuar në mundësinë e kursimit të përlllogaritur nga Komisioni, në mungesë të akteve mbi gjendjet e llogarive bankare për periudhën deri në **.5.2012; (iv) Mospërfshirjen e blerjes së pasurisë *Automjet*, në shumën 13.000 USD, duke e lidhur me qenien në pamundësi për të vënë në dispozicion të hetimit balancat e llogarive bankare që nga viti 2004 e në vijim; (v) Rishikimin e shumës së marrë me vete nga subjekti dhe familjarët e tij, kur kanë shkuar në SHBA, në total në vlerën 20.000 USD; (vi) Për vitet 2003-2004, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar pamundësi objektive për të siguruar dokumentacion kaq të hershëm lidhur me të ardhurat.

17.3 Komisioni, pasi ka vlerësuar pretendimet dhe aktet e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij, ka vlerësuar¹⁷ të bazuara pretendimet mbi përfshirjen në analizën financiare të shumave të rimbursuara nga taksat, nga shteti amerikan, për subjektin dhe vëllain e tij; rishikimin e të ardhurave nga puna e të atit të subjektit, në SHBA, dhe ato si administrator i shoqërisë “****” sh.p.k.; rishikimin e balancave të likuiditeteve në llogaritë bankare në datën e blerjes së pasurisë, si dhe ka rishikuar pjesërisht shpenzimet e jetesës për periudhën e analizuar 2005 – **.5.2012.

17.4 Komisioni ka vlerësuar se periudha që duhet marrë në analizë është duke filluar nga viti 2005, referuar fakteve dhe rrethanave si vijon: (i) Për sa i përket periudhës gusht 2003 - dhjetor 2004, Komisioni ka vlerësuar se shuma prej 20.000 USD, deklaruar nga subjekti gjatë hetimit administrativ si shumë e disponuar në *cash* në momentin e largimit në SHBA, nga subjekti dhe familjarët, ka qenë e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës për të njëjtën periudhë¹⁸; (ii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka krijuar pasuri në vitet 2003-2004 dhe as likuiditete të mbartura në Deklaratën “Vetting”; (iii) Llogaria bankare e subjektit është çelur në gusht 2004, për arsye praktike dhe jo për të krijuar pasuri/likuiditete; (iv) Subjekti nuk ka pretenduar që të ardhurat e periudhës 2003-2004 të kenë shërbyer si burim për krijimin e ndonjë pasurie; (v) Subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI dokumente shkresore për të ardhurat që nga viti 2005; (vi) Këto dokumente janë printuar nga sistemi i taksave në vitin 2014, vit në të cilin subjekti ka pasur mundësi që, teknikisht, të printonte dhe të ardhurat për vitin 2004. Fakti që nuk e ka bërë, përforcon bindjen se subjekti ka dashur të deklarojë burim krijimi të pasurive të ardhurat nga viti 2005 e në vijim¹⁹. Komisioni, ndër të tjera, ka vlerësuar edhe se: ... “I pyetur nga Komisioni në lidhje me të ardhurat e periudhës gusht 2003 - dhjetor 2004, si në parashtrime, ashtu edhe në përgjigje të Pyetësorit nr. 6, subjekti, me të drejtë, ka deklaruar se sot është në pamundësi objektive që të dokumentojë këto të ardhura”²⁰.

17.5 Bazuar në arsyetimet si më sipër, Komisioni, në përfundim të procesit, ka vlerësuar se u vërtetua se subjekti, z. Gramshi, ka pasur të ardhura të ligjshme për të paguar shumën 75.638 USD deri në datën **.5.2012, për blerjen e pasurisë “Shtëpi me sip.180 m², në New York, SHBA”.

17.6 Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara në dosje të Komisionit, bazuar në Rekomandimin për paraqitje ankimi të ONM-së, datë 16.5.2022, i drejtohet juridiksionit kontrollues të Kolegjit, për çështjet lidhur me: (i) ekzistencën e pamundësisë objektive të

¹⁷ Referohuni prg. 49, të vendimit të Komisionit.

¹⁸ Komisioni, fillimisht, në rezultatet e hetimit ka konsideruar që subjekti dhe familjarët kishin marrë me vete shumën 60.000 USD, por e ka rishikuar këtë shumë në bazë të prapësimeve të subjektit.

¹⁹ Referohuni arsyetimit të Komisionit, në prg. 49.1 të vendimit.

²⁰ Referohuni prg. 49.1, pika v, të vendimit të Komisionit.

pretenduar për paraqitje dokumentacioni nga subjekti, z. Gramshi, për periudhën 2003-2004; dhe (ii) pamjaftueshmërinë financiare për pagesat e kështit të parë dhe të dytë, që janë burim krijimi për pasurinë “Shtëpi banimi me sip.180 m², në New York, SHBA”, pasur në konsideratë rrethanat e parashtruara në Rekomandimin e ONM-së,²¹ për sa vijon:

17.6.1 Për pamundësinë objektive të pretenduar

17.6.1.1 [...] Lidhur me pamundësinë objektive për të siguruar dokumentacion për vitet 2003 dhe 2004, subjekti i rivlerësimit pretendoi se kishte të ardhura të ligjshme për vitin 2003 dhe vitin 2004, por që është në pamundësi objektive për të siguruar dokumentacionin për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar. Subjekti deklaroi se autoritetet e SHBA-së lëshojnë dokumente të lidhura me taksat jo më të vjetra se 10 vite [...].

17.6.1.2 [...] Kur subjekti i rivlerësimit filloi detyrën në vitin 2014 - si pjesë e deklarimit para se të ushtronte detyrën - ai siguroi dokumente të të ardhurave për kohën kur jetoi në SHBA. Shumica e dokumenteve ishin “tax return” (vetëdeklarime) dhe disa prej tyre ishin “tax transcript” (për vitet 2010-2013), të cilat ishin shkarkuar nga faqja e internetit të Internal Revenue Services, në * maj 2014. Në atë moment, subjekti i rivlerësimit nuk ishte në pamundësi objektive për të siguruar dokumentacion që provonte të ardhurat e ligjshme në periudhën 2003-2004. Për më tepër, subjekti i rivlerësimit u bë rezident i ligjshëm në SHBA në muajin korrik 2004 [...].

17.6.1.3 [...] Duhet theksuar se është në diskutim nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme për periudhën gusht 2003 – korrik 2004, për sa kohë që nuk kishte leje pune nga autoritetet e SHBA-së. Gjithashtu, edhe i ati dhe i vëllai, nuk mund të krijonin të ardhura të ligjshme për të njëjtën periudhë për të njëjtat arsye [...].

17.6.1.4 [...] Për më tepër, fakti që subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumente të pagimit të taksave për gjithë periudhën 2003-2004, tregon që nuk ka pasur të ardhura të ligjshme, sesa të qenët në kushte të pamundësisë objektive për të siguruar dokumentacion të tillë sikurse ai ka pretenduar (në vitin 2014, kur ai paraqiti për herë të parë deklaratën para emërimit në detyrë, subjekti nuk ishte në kushte të tilla) [...].

17.6.1.5 [...] Për më tepër është e dukshme se, nëse subjekti donte të deklaronte se burim i krijimit të pasurive të tij në Amerikë ishin fitimet e viteve 2005 e në vijim, ai mund ta bënte këtë në secilën prej deklaratave vjetore. Pasur parasysh se subjekti nuk ishte i ligjshëm për punë deri në muajin korrik 2004 dhe se ai nuk ka paraqitur dokumentacion për periudhën 2003-2004, ky është një tregues që nuk ka pasur të ardhura të ligjshme deri në vitin 2005 [...].

17.6.2 Për pamjaftueshmërinë financiare

17.6.2.1 [...] ONM është e qëndrimit se vlerësimi i pasurisë dhe analiza financiare përkatëse duhet, gjithashtu, të përfshijë edhe vitet përpara 2005, veçanërisht vitet 2003 -2004. Në këto kushte subjekti dhe familja e tij do të rezultonin në pamundësi financiare për të paguar kështin e dytë dhe analiza financiare do të rezultonte me një balancë negative prej rreth – 16.088 USD [...].

²¹ Referohuni pikës 2, germa “c”, faqe 9; germa “a”, faqe 6; dhe germa “b”, faqe 7-8 e Rekomandimit të ONM-së.

17.6.2.2 [...] Marrë në konsideratë se: (i) shuma e transferuar nga familja Gramshi në SHBA ka qenë 20.000 USD; (ii) shpenzimet minimale të jetesës për vitet 2003 – 2004 ishin rreth 50.000 USD, shumë e cila është e lartë se shuma 20.000 USD, e konsideruar nga Komisioni për të mbuluar shpenzimet e jetesës për këtë periudhë, (iii) subjekti i rivlerësimit, asnjëherë, nuk ka deklaruar se pasuritë e krijuara në SHBA të kishin si burim të ardhurat e periudhës 2005 -2014, përkundrazi, ai ka deklaruar që pasuritë e krijuara në SHBA kishin si burim të ardhurat përpara fillimit të detyrës në vitin 2014, çka nënkupton të gjithë periudhën midis viteve 2003-2014 dhe periudha përpara 2003 është jorelevante, pasi subjekti ka deklaruar se shuma e transferuar nga Shqipëria në SHBA ishte vetëm 20.000 USD [...].

17.6.2.3 [...] Konkluzioni i Komisionit në prg 49.1: (i) “se asnjë pasuri nuk është krijuar në periudhën 2003-2004”, është i pasaktë. Megjithëse balanca e llogarisë bankare (që është një pasuri) në vitin 2004 është e panjohur, sipas deklarimit të subjektit, ajo është hapur në vitin 2004 [...].

17.7 Komisioneri Publik vëren se rrethanat e pasqyruara në Rekomandimin e ONM-së, përkundrejt pretendimit të subjektit për pamundësi objektive për të paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e ligjshme në periudhën 2003-2004, dëshmojnë se subjekti, z. Gramshi, në momentin e plotësimit të *Deklaratës së parë përpara fillimit të detyrës (dorëzuar më **8.2014)*, e kishte mundësinë që ofronte sistemi i “IRS”²² për të siguruar dokumentacionin, së paku për vitin 2004, ndaj dhe pamundësia objektive, sipas kuptimit të nenit 32, pika 2 e ligjit 84/2016, nuk gjendet e justifikuar.

17.8 Komisioneri Publik, sa më sipër, vlerëson se, në konsideratë të kryerjes së analizës financiare, duke nisur që nga viti 2003 (muaji shtator), marrë në konsideratë si të ardhura në dispozicion të subjektit dhe familjarëve të tij, për periudhën 2003 – 2004, shumën prej 20.000 USD (deklaruar të marrë në *cash*) dhe shpenzimet minimale të jetesës për të njëjtën periudhë²³, rezultatet e analizës financiare do të ndryshonin mundësinë për kursim të subjektit dhe familjarëve të tij, duke rezultuar në pamjaftueshmëri financiare për periudhën shtator 2003 - **5.2012, për një shumë të akumuluar në vlerën rreth - 16.000 USD.

18. Në përfundim, Komisioneri Publik, për pasurinë “Shtëpi me sip.180 m², në New York, SHBA”, vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b”, dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

19. Depozita në * Bank dhe ** Bank në New York, SHBA**

19.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar depozita bankare në shtetin amerikan respektivisht: (i) *Depozitë *** Bank (New York, SHBA), krijuar në gusht 2004 dhe gjendje më datë **12.2016, shuma 82.684,64 USD. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: Të ardhurat nga pagat;* (ii) *Depozitë ** Bank (New York, SHBA), krijuar në nëntor 2013 dhe gjendje më datë **12.2016, shuma 263,51 USD. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: Të ardhurat nga pagat.*

²² Internal Revenue Service/Shërbimi i brendshëm i të ardhurave.

²³ Shtator 2003 – prill 2004 për 3 (tre) persona dhe maj 2004 – dhjetor 2004 për 4 (katër) persona , si dhe shtuar shpenzimet për qira për periudhën shtator 2003- dhjetor 2004.

19.2 Në Deklaratën para fillimit të detyrës (dorëzuar në ILDKPKI, datë **.8.2014), subjekti ka deklaruar: (i) *Depozitë *** Bank (New York, SHBA), krijuar në gusht 2004 dhe gjendje më datë **.7.2014, shuma 97.614,28 USD. Pjesa takuese: 100%. Burim krijimi: Të ardhurat nga paga;* (ii) *Depozitë ** Bank (New York, SHBA), krijuar në nëntor 2013 dhe gjendje më datë **.7.2014, shuma 12.736,66 USD. Pjesa takuese: 50%. Burim krijimi: të ardhurat nga pagat.*

19.2.1 Komisioni ka vlerësuar se deklarimi i subjektit përputhet me gjendjen e llogarive në datat **.7.2014 dhe **.12.2016, ndërsa për sa i takon të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e depozitave në vlerën totale prej 110.351 USD, në datë **.7.2014, Komisionit fillimisht, nga analiza financiare për periudhën 2005-**.7.2014, i ka rezultuar se subjekti dhe familja e tij nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t'i krijuar këto depozita për një diferencë negative prej -156.153 USD, diferencë për të cilën, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës.

19.3 Në prapësimet tij, subjekti ka pretenduar se në analizën financiare të Komisionit duhet të reflektohen të njëjtat shpjegime dhe argumente të trajtuara gjerësisht në analizën financiare të kryer deri në momentin e blerjes së pasurisë “Shtëpi me sip.180 m², New York, SHBA”, në vitin 2012, duke shtuar edhe: “(i) ...shumën e taksave të rimbursuara nga shteti gjatë viteve 2013 dhe 2014, në shumën totale 16.919 USD (10.520/viti 2013+6.399/viti 2014); (ii) të ardhurat nga puna e babait deri në momentin e plotësimit të dokumentacionit për pension dhe më pas përfitimet nga pensioni i parakohshëm i pleqërisë²⁴”.

19.4 Komisioni, pasi ka vlerësuar pretendimet dhe aktet e vëna në dispozicion nga subjekti, në përfundim ka vlerësuar se ai ka pasur mundësi të krijojë depozitat objekt verifikimi me të ardhura të ligjshme të krijuara në SHBA²⁵.

19.5 Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara, bazuar në Rekomandimin për paraqitje ankimi të ONM-së, datë 16.5.2022, i drejtohet juridiksionit kontrollues të Kolegjtit, për çështjen e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit, z. Gramshi, dhe personave të lidhur me të²⁶, pasur në vëmendje rrethanat e parashtruara në Rekomandimin e ONM-së, për sa vijon²⁷:

19.5.1 [...] *Nga aktet në dosje konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka krijuar një pasuri në vitin 2004, llogari bankare. Megjithëse nuk ka të dhëna mbi gjendjen e kësaj llogarie në momentin e krijimit të saj, likuiditetet që janë mbartur në Deklaratën “Vetting” rrjedhin ekzaktësisht nga kjo llogari dhe, në përputhje me vetë natyrën e vlerësimit të pasurisë, analiza duhet të shtrihet edhe për vitet 2003-2004 [...].*

19.5.2 [...] *Pasaktësia gjendet edhe në pjesën e vendimit të Komisionit, ku arsyetohet se²⁸ “subjekti nuk ka pretenduar që të ardhurat e periudhës 2003-2004 të kenë shërbyer si burim për krijimin e ndonjë pasurie”, pasi rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në Deklaratën “Vetting” dy pasuri: (i) Shtëpi në New York, SHBA, me burim krijimi, përveç*

²⁴ Referohuni shpjegimeve të subjektit, në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, f. 36 e në vijim.

²⁵ Referohuni arsyetimit në paragrafët nr. 70.2-70.3 të vendimit të Komisionit.

²⁶ Për vitin 2005 deri në vitin 2012, në rrethin e personave të lidhur janë konsideruar, përveç familjes së subjektit, prindërit dhe familja e vëllait, ndërsa për periudhën në vijim janë konsideruar, përveç familjes së subjektit, edhe prindërit e tij.

²⁷ Referohuni pikës 2, germa “b”, faqe 8-9 e Rekomandimit të ONM-së.

²⁸ Referohuni paragrafit 49.1, pika iii, të vendimit të Komisionit.

kredisë, edhe të ardhura të krijuara përpara fillimit të detyrës në vitin 2014; si dhe (ii) depozita bankare në SHBA, krijuar në gusht të vitit 2004, me burim të ardhurat nga pagat [...].

